



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

OSHP: 2024/0614

Data e Vendimit: 11.07.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020pas pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik OE “Delta Security” SH.P.K. kundër njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se” me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, ud. Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën: 11.07.2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Hedhet si e palejuar**, ankesa e “Delta Security” SH.P.K me nr. të protokollit 2024/614 e datës 10/07/2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se”, me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.
- II. I lejohe**t, autoritetit kontraktues – Komuna Prishtinë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se” me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të

Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Në sistemin elektronik në e-prokurim ankesa është paraqitur me datë 10.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se” me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, iniciuar Komuna Prishtinë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 12.05.2024, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë, ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 11.06.2024.

Me datën 07.06.2024 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 18.06.2024.

Me datën 05.07.2024 AK ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara ku sipas këtij njoftimi afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data: 10.07.2024.

OE “Delta Security” SH.P.K me 09.07.2024 OE kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, ndërsa me datë 10.07.2024 AK ka hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se” me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës, njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 12.05.2024, afati i fundit për praninë të tenderëve ishte data 10.07.2024, ndërsa me datë 09.07.2024 OE “Delta Security” SH.P.K kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 10.07.2024 e ka hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim operatorit ekonomik.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtrorj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “...në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). **Ky afat nuk aplikohet ne rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje...**”. Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 10/07/2024 nga OE “Delta Security” SH.P.K për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve te institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve te QKMF, QMF -se dhe QMU-se”, me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, iniciuar nga Komuna Prishtinë, hedhet e palejuar sepse e njëjta nuk është parashtruar në pajtim me nenin 108/A të LPP-së si dhe nenin 60 par.1 të Rregullores për Prokurim Publik. Po ashtu referuar interpretimit të KRPP-së të datës 07.11.2023, 630/2023, i cili interpretim sqaron afatet ligjore për ankimim, konstatojmë se kjo ankesë hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim me date 09.07.2024. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)”. Në rastin konkret sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, hapja e ofertave është paracaktuar me datë 10.07.2024 në ora 14:00. Kjo nënkupton që data 10.07.2024 është dita zero (0) ndërsa data e fundit kur kanë mundur të parashtrohen kërkesa për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka qenë data 04.07.2024 deri në ora 16:00. Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e datës 09.07.2024 (pra vetëm një ditë para hapjes së ofertave) është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Megjithatë, OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik.

Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen *vetëm në kriteret e nevojshme* për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues *nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.* Andaj OSHP i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj koform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve të QKMF, QMF -se dhe QMU-se” me numër të prokurimit 616-24-4595-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të vendimit.

Vendimi ti dorëzohet:

- AK – “Komuna Prishtinë”
- OE - “Delta Security” SH.P.K
- Arkivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri
Ud. i Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së

